



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

RAPORTI I PUNËS
I GRUPEVE PUNUESE PËR DECENTRALIZIM
(Shtator 2010 – Shkurt 2011)

Shkurt, 2011

Hyrje

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në përputhje me mandatin e saj ligjor, që nga viti 2008 ka hartuar dhe po zbaton Strategjinë dhe Planin e veprimit për zbatimin e decentralizimit.

Pas skadimit të mandatit të GND-së, me vendim të ri të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 3/119 të datës 07.04.2010, mandati i Grupit Ndërministror për Decentralizim është zgjatuar deri më 4 prill 2012, ndërkaq që sipas këtij vendimi është bërë dhe miratimi i Planit të Veprimit për Zbatimin e Decentralizimit me ndryshimet përkatëse.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal në përputhje me këtë vendim të Qeverisë, me Vendimin e saj të datës 25 Maj 2010, ka themeluar katër grupet punuese: Grupi Punues për Themelimin e Komunave të Reja; Grupi Punues për Reformën e Legjislacionit dhe Bartjen e Kompetencave; Grupi Punues për Koordinim me Donatorë dhe Ngritjen e Kapaciteteve; si dhe Grupi Punues për Kontaktim me Publikun.

Në bashkëpunim dhe koordinim të ngushtë me Zyrën Civile Ndërkombëtare është bërë funksionalizimi i të gjitha grupeve punuese, që ka rezultuar në mbajtjen e takimeve të rregullta.

Ky raport në përgjithësi bën prezantimin e aktiviteteve dhe rezultateve të arritura deri në muajin Shkurt 2011 që nga takimi i fundit të Grupit Ndërministror për Decentralizim i mbajtur në muajin shtator 2010.

Përmbajtja:

Hyrje

Lista e shkurtesave

Përmbledhje ekzekutive

Aktivitetet e Grupeve Punuese dhe prioritetet në tremujorin e ardhshëm

- *Grupi Punues për Themelimin e Komunave të Reja (GPTHKR)*
- *Grupi Punues për Reformën e Legjislacionit dhe Bartjen e Kompetencave (GPRLBK)*
- *Grupi Punues për Koordinimin e Donatorëve dhe Ngritjen e Kapaciteteve (GPKDNK)*
- *Grupi Punues për Kontaktim me Publikun (GPKP)*

Rekomandime

Lista e shkurtesave

MAPL - Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

ZCN - Zyra Civile Ndërkombëtare

GND - Grupi Ndërmintor për Decentralizim

GPTHKR -Grupi punues për themelimin e Komunave të reja

GPRLBK - Grupi punues për reformën e legjislacionit dhe bartjen e kompetencave

GPKDNK - Grupi punues për koordinim me donatorë dhe ngritjen e kapaciteteve

GPKP - Grupi punues për kontaktim me publikun

MEF - Ministria e Ekonomisë dhe Financave

MSH - Ministria e Shëndetësisë

MASHT - Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë

MPB - Ministria e Punëve të Brendshme

MPMS - Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale

MBPZhR - Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

MAP - Ministria e Administratës Publike

MKRS - Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

AKK - Asociacioni i Komunave të Kosovës

EPK - Ekipi Përgatitor Komunal

UNDP - Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara

USAID - Agjencia për zhvillim ndërkombëtar e Shteteve të bashkuara të Amerikës

ZNKE - Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian

OSCE - Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë

Përmbledhje Ekzekutive

1. Ka përfunduar konstituimi dhe funksionalizimi i Kuvendeve të Komunave dhe administratës së komunave Graçanicë/Gračanica, Klllokoti/Klokot, Ranillug/Ranilug, si edhe të komunës së Parteshit/Parteš.
2. Janë duke u zbatuar Marrëveshjet e Mirëkuptimit mes komunave amë dhe komunave të reja me qëllim bartjen e dokumentacionit për gjendjen civile, tatimin në pronë, urbanizmin, si dhe kadastrën.
3. Janë zbatuar Planet e veçanta të trajnimit për komunitatet e reja, të përgatitura nga MAPL, që kanë synuar shtimin e kapaciteteve të administratës lokale, si edhe përgatitjen e anëtarëve të Kuvendeve të Komunave të reja.
4. Është ngritur dhe funksionalizuar Ekipi Përgatitor Komunal në Mitrovicën e Veriut. Puna e EPK është zhvilluar në bashkëpunim të ngushtë me Zyrën Civile Ndërkombëtare dhe ka pasur mbështetjen e donatorëve dhe partnerëve nga fusha e qeverisjes lokale.
5. Janë ndërmarrë aktivitetet e duhura për shtimin e të hyrave vetanake për komunitatet e reja, sidomos ato që lidhen me grumbullimin e taksave të gjobave në komunikacion dhe taksave për parkingje.
6. Ministrinë e linjës kanë raportuar në mënyrë të vazhdueshme në lidhje me progresin e arritur në komunitatet e reja dhe aktivitetet që janë zhvilluar me Ekipin Përgatitor Komunal në Mitrovicën e Veriut.
7. Është zbatuar Strategjia Legjislative e parashikuar për vitin 2010, ndërkohë që është hartuar Strategjia Legjislative 2011.
8. Është hartuar lista e OJQ-ve që kanë fituar të drejtën e marrjes së fondeve nga Qeveria e Kosovës për implementimin e aktiviteteve që do të rezultojnë në ngritjen dhe stimulimin e marrëdhënieve ndërmjet komuniteteve të ndryshme në veriun e Kosovës.
9. Janë miratuar strategjitë për zhvillim të komunave të Graçanicës/Gračanica, Klllokotit/Klokot dhe Ranillugut/Ranilug. Komunitatet e Parteshit/Parteš është në proces të hartimit të kësaj strategjie.
10. Deri tani janë realizuar 29 projekte për infrastrukturën e komunave të reja/objektet e tyre administrative.
11. Aktivitetet në fushën e ngritjes së kapaciteteve të komunave të reja dhe Ekipit Përgatitor Komunal në Mitrovicën e Veriut kanë pasur mbështetjen e vazhdueshme të partnerëve, si: UNDP, ZNKE, USAID, OSCE etj.
12. Janë përgatitur dhe transmetuar katër dokumentarë që paraqesin procesin e decentralizimit si tregim i suksesshëm për Kosovën në drejtim të themelimit të komunave të reja, bartjes së kompetencave në komunitatet, investimeve në komunitatet dhe nevojën e implementimit të procesit të decentralizimit në Veri.
13. Administratat e reja komunale kanë përgatitur buxhetet që do të përfshihen në Buxhetin e Kosovës për vitin 2011.

Aktivitetet e Grupeve Punuese

Grupi Punues për Themelimin e Komunave të Reja (GPTHKR)

Në takimin e fundit të mbajtur në muajin Shkurt 2011, Grupi punues për themelimin e komunave të reja ka prezantuar raportin mbi progresin e arritur në vitin 2010, veçanërisht në komunat e reja të themeluara.

Qëllimi kryesor i grupit punues për themelimin e Komunave të reja ka qenë realizimi i masave përgatitore mbi themelimin e të gjitha Ekipeve Përgatitore Komunale, si dhe përmbylljen me sukses të proceseve zgjedhore që kanë bërë të mundur zgjedhjen e organeve demokratike në Komunën e Graçanicës/Gračanica, Kllokotit/Klokot, Ranillugut/Ranilug, Novobërdës/Novo Brdo (e zgjeruar) dhe në Komunën e Parteshit/Parteš. Ky proces përfundoi me konstituimin e kuvendeve komunale të dala nga zgjedhjet e 15 Nëntorit 2009 në Graçanicë/Gračanica, Ranillug/Ranilug, Kllokot/Klokot, Novobërdë/Novo Brdo (e zgjeruar), si dhe emërimi i drejtorëve të drejtorive përkatëse dhe rekrutimi i stafit. Për komunën e Parteshit/Parteš ky proces përfundoi pas realizimit me sukses të zgjedhjeve në qershor 2010.

Me qëllim bartjen e dokumentacionit nga komunat amë tek komunat e reja është bërë nënshkrimi i Marrëveshjes së Mirëkuptimit, duke përfshirë dokumentacionet që kanë të bëjnë me: gjendjen civile, tatimin në pronë, urbanizmin, si dhe kadastrën. Progresi i arritur deri më tani në bartjen e dokumentacionit ka shërbyer për funksionalizimin më të mirë të organeve komunale, duke shtuar cilësinë e ofrimit të shërbimeve për qytetarët.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal në bashkëpunim me UNDP-në kanë përkrahur Komunat e reja me pajisje Harduerike dhe Program të licencuar të kadastrës, kompjuterë etj., duke siguruar që funksionalizimi i zyrave me kapacitete të plota.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka hartuar një plan të veçantë trajnimesh për komunat e reja që synonte rritjen e kapaciteteve, duke pasur dhe mbështetjen e partnerëve të përfshirë në programe dhe projekte në fushën e qeverisjes lokale. Në këtë cikël trajnimesh përfshiheshin fushat: Legjislacion për Qeverisjen; Roli i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Reforma në Qeverisjen Lokale; Draftimi i Akteve Normative; Planifikimi i Buxhetit; Menaxhimi i Projekteve; Menaxhimi i Resurseve Njerëzore; Regjistrimi Civil dhe Barazia Gjinore në Komuna; Menaxhimi i Performancës Komunale, Zhvillimi dhe Implementimi i të hyrave vetanake komunale, Teknikat e Hartimit të Legjislacionit, si dhe trajnimi i specializuar në përdorimin e pajisjeve harduerike dhe softuerë të programit të kadastrës.

Për një ecure të mirë të punës së Kuvendeve të sapozgjedhura të komunave të reja janë organizuar edhe trajnime pas zgjedhjeve lokale, me tema: Roli i Anëtarëve të Kuvendit

Komunal; Infrastruktura Ligjore mbi Vetëqeverisjen Lokale; Efikasiteti i Punës së Kuvendit Komunal; Roli i Opozitës dhe Pozitës në Kuvendin Komunal; Demokracia Lokale; Roli i Shoqërisë Civile dhe Pjesëmarrja Qytetare në Vendim-Marrje.

Gjatë kësaj periudhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka realizuar Investime kapitale në të gjitha komunat e reja: Graçanicë/Gračanica, Ranillug/Ranilug, Kllokot/Klokot, Partesh/Parteš, Novobërdë/Novo Brdo, përfshirë dhe në Mitrovicën e Veriut. Po ashtu, vetë komunat kanë realizuar projekte infrastrukture me procedurat e veta të prokurimit.

Ekipi Përgatitor Komunal në Mitrovicën e Veriut ka filluar punën në Shkurt 2010. Ky ekip përbëhet nga 11 anëtarë dhe mbështetet nga tre anëtarë të tjerë, një nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe dy nga Zyra Civile Ndërkombëtare në Mitrovicë.

Ekipi Përgatitor Komunal në Mitrovicën e Veriut është ekip teknik që bën adresimin e problemeve që atakojnë cilësinë e jetës së qytetarëve në atë pjesë të rajonit dhe bën përpjekje për tejkalimin e tyre nëpërmjet zbatimit të infrastrukturës, si dhe projekteve të ndryshme. Ky ekip është i ndarë në tri nëngrupe:

- 1) Nëngrupi për informim publik,
- 2) Nëngrupi për akte normative dhe buxhet,
- 3) Nëngrupi për projekte dhe investimet kapitale

Të gjitha aktivitetet e parashikuara të Ekipit Përgatitor Komunal zhvillohen në bashkëpunim të ngushtë me ZNC-në në Mitrovicë si dhe donatorë të ndryshëm.

Projekti DEMI (Iniciativa për Komuna Efektive dhe Demokratike, financuar nga USAID) ka përkrahur Ekipin Përgatitor Komunal në Mitrovicë, duke ofruar trajnime në hartimin e projekt propozimeve, gjë që ka rezultuar në pesë projekte të zbatuara në Mitrovicën e Veriut para fundit të vitit 2010. Këtu përfshihen: zbatimi i projektit të Parkut dhe Kopshtit në qendër të qytetit, dekorimi i qytetit për festat e fundvitit, shpërndarje e drunjve për ngrohje për familjet në nevojë (financuar nga MAPL), një konkurs fotografik (financuar nga ZCN), si dhe mirëmbajtja e faqes së internetit të EPK-së.

Ekipi Përgatitor Komunal po punon bashkërisht me projektin DEMI për pesë projekte të tjera infrastrukture që planifikohet të nisnin në prill 2011.

Nga ana administrative, Ekipi Përgatitor Komunal po punon në bashkëpunim me MAPL, ZCN dhe projektin DEMI për të përfunduar: strukturën organizative për Komunën, dizajnimin e përshkrimit të vendeve të punës, ndërtimi i kapaciteteve për anëtarët e EPK-së, dizajnimi dhe implementimi i projekteve në vlerë prej 1 Milion Euro përgjatë 2 viteve të ardhme, dhe posaçërisht vazhdimësi e përkrahjes në ngritjen e 'prezencës' së Ekipit Përgatitor Komunal në Mitrovicën e Veriut përmes aktiviteteve me profil publik të shtuar.

Në lidhje me inkasimin e të hyrave në komunat e reja, veçanërisht me grumbullimin e taksave të gjobave në komunikacion dhe taksave për parkingje, MAPL ka organizuar takimin me përfaqësues të komunave të Graçanicës/Gračanica, Novobërdës/Novo Brdo (e zgjeruar) dhe ministritë e linjës. Në takim u vlerësua domosdoshmëria që komunat e reja duhet të miratojnë Rregulloret komunale për këtë qëllim. Komuna e Graçanicës/Gračanica e ka miratuar këtë Rregullore, ndërkohë pritet që edhe komunat Ranigllug/Ranilug, Partesh/Parteš dhe Kllokot/Klokot të miratojnë këto rregullore.

Komuna e Novobërdës/Novo Brdo (e zgjeruar) ka arritur progres falë ndihmës së dhënë nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Zyra Civile Ndërkombëtare dhe organizatat e tjera ndërkombëtare me realizimin e projekteve të ndryshme për qytetarë të kësaj komune. Kjo ka rezultuar në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve që u ofrohen qytetarëve. Progres është arritur edhe në bartjen e dokumentacionit nga komuna amë në Komunën e zgjeruar të Novobërdës/Novo Brdo.

Ministria e Administratës Publike ka realizuar aktivitete për funksionalizim të administratës në bashkëpunim të ngushtë me Ekipet Përgatitore Komunale, duke këshilluar, udhëzuar rreth strukturave organizative të administratës, përshkrimeve të detyrave dhe përgjegjësive të punës, rreth aprovimit të procedurave të titujve të punës, procedimit të nëpunësve në sistemin e pagave.

Të gjitha komunat e reja kanë funksionalizuar zyrat e personelit, duke i pajisur ato dhe me infrastrukturën e nevojshme ligjore. Gjithashtu, është bërë edhe organizimi i forumit të përhershëm të menaxherëve/udhëheqësve të personelit ku bëhet prezantimi i të gjitha rregulloreve, merren parasysh dhe shqyrtohen shqetësimet rreth zbatimit të ligjit për shërbyesit civil. Ky proces do të realizohet edhe me Ekipin Përgatitor Komunal në Mitrovicën e Veriut, posaçërisht në çështjet që kanë të bëjnë me administratën/shërbimin civil.

Ministria e Punëve të Brendshme ka hapur zyrat e gjendjes civile në komunat e reja Graçanicë/ Gračanica, Partesh/Parteš, Kllokot/Klokot, Ranillug/Ranilug, të cilat janë funksionale dhe iu ofrojnë të gjithë qytetarëve mundësinë që të pajisen me të gjitha dokumentet e regjistrimit civil.

Zyrtarëve të gjendjes civile iu është ofruar trajnim përkatës me qëllim të familjarizimit me Legjislacionin dhe Udhëzimet që kanë të bëjnë me gjendjen civile në përgjithësi. Ndërkohë që çështja e bartjes dhe kopjimit të dokumentacionit të nevojshëm nga komunat amë për nevoja të komunave të reja është procedurë në vazhdimësi, bartja e të dhënave elektronike nga komunat amë për banorët e fshatrave që i përkasin komunave të reja është çështje që do të jetë në procedurë të vazhdueshme deri në realizim të tërësishëm.

Sa i përket pjesës veriore të Komunës së Mitrovicës, punëtorët e gjendjes dhe regjistrimit civil, si dhe ata të regjistrimit të automjeteve janë duke ofruar shërbime për të gjithë qytetarët që të pajisen me certifikata të ndryshme, përfshirë dhe dokumentet e identifikimit

dhe pasaporta. Planifikohet që në të ardhmen këto aktivitete të realizohen në bashkëpunim të ngushtë me Ekipin Përgatitor Komunal të Komunës së Mitrovicës.

Ministria e Ekonomisë dhe Financave është angazhuar me komunat e reja, veçanërisht në tabelat e buxhetit, dokumente, menaxhim dhe ofrim të trajnimeve të ndryshme. Kjo Ministri është përqendruar në mënyrë të veçantë në aftësimin e zyrtarëve të komunave të reja në fushën e menaxhimit të financave publike, duke bërë të mundur që komunat e reja të dorëzojnë projekt-buxhetet e tyre. Planifikohet që të organizohet edhe forumi me liderët komunal për planifikim të buxhetit 2012-2014. Tabelat e buxhetit 2011 janë finalizuar dhe pritet të dorëzohen në Qeveri dhe Kuvend në mënyrë që të bëhet aprovimi i buxhetit për këtë vit.

Agjencia Kadastrale e Kosovës ka ofruar mbështetje për komunat e reja nëpërmjet trajnimeve të ndryshme sipas nevojave të komunave.

Grupi punues për themelimin e komunave të reja vlerëson se është e domosdoshme pjesëmarrja e komunave amë në takimet e rregullta të këtij grupi me qëllimin rritjen e koordinimit mes komunave amë dhe komunave të reja.

Fokusi i aktiviteteve në periudhën e ardhshme 3 mujore të punës së Grupit Punues për Themelimin e Komunave të reja

Vëmendje e posaçme do të adresohet tek aktivitetet/veprimet në veriun e Kosovës. Do të ketë një bashkëpunim të ngushtë me Ekipin Përgatitor Komunal të Mitrovicës së Veriut, me qëllim të intensifikimit dhe adresimit të kërkesave dhe shqetësimeve. Një bashkëpunim i tillë planifikohet të realizohet në koordinim të plotë me Zyrën Civile Ndërkombëtare.

- Rishikimi dhe miratimi i termave të referencës për Ekipin Përgatitor Komunal në Mitrovicë
- Riorganizimi i Ekipit Përgatitor Komunal në Mitrovicë
- Organizimi i trajnimeve në fushën e buxhetit dhe financave për Ekipin Përgatitor Komunal në Mitrovicë
- Vazhdimi i punës për bartjen e dokumentacionit nga komunat amë në komunat e reja
- Puna për kompetencat e deleguara dhe të shtuara. Ngritja e komunave të reja në përputhje me aneksin III të Propozimit Gjithpërfshirës për Statusin e Kosovës.

Grupi Punues për Reformën e Legjislacionit dhe Bartjen të Kompetencave (GPRLBK)

Ky grup punues në takimin e fundit të mbajtur në nëntor 2010, ka shënuar progres në identifikimin e projekt-ligjeve sipas Ministrive të linjës, ku përfshihen:

Ministria e Ekonomisë dhe Financave - Ligji për Tatimin në Pronën e Paluajtshme në Kosovë është në fuqi dhe është dekretuar me datë, 01.11.2010.

Ministria e Punëve të Brendshme - Është angazhuar në tre projekt-ligje në fushën e qeverisjes lokale: Projektligji për Mbrojtje nga Zjarri, Projektligji për Zjarrfikje dhe shpëtim, Projektligji për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e tjera.

Projektligji për Mbrojtje nga Zjarri është proceduar në Ministrinë e Financave dhe është në pritje për të marr deklaraten e vlerësimit të ndikimit financiar. Pas Kësaj, ky projektligj do të procedohet për miratim në Qeveri.

Projektligji për Zjarrfikje dhe shpëtim i është lëshuar deklarata nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave për vlerësimin e ndikimit financiar dhe është rekomanduar që bëhet harmonizimit me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal.

Projektligji për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera është ne grupin punues qeveritar dhe drafti i projektligjit është ne fazën finale.

Ministria e Administratës Publike - Projektligji për Procedurën Administrative është përfshirë në Strategjinë Legjislative për vitin 2011.

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë - Ligji për Shërbimet Hoteliere Turistike është miratuar dhe është në zbatim e sipër.

Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor - Projektligji për Mbeturinat është përfshirë në Strategjinë Legjislative për vitin 2011.

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale - Projektligji për ndryshim dhe plotësimin e Ligjit për skemën e ndihmës sociale kalon për plotësim dhe ndryshim do të jetë në Strategjinë Legjislative për vitin 2011.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal - Projektligji për Bashkëpunimin Ndërkomunal dhe Partneritete, afati i dorëzimit në Qeveri 30 mars 2011; Projektligji për Amandamentimin e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, afati i dorëzimit 30 shtator 2011; Projektligji për Qytetin e Prishtinës, afati i dorëzimit 30 shtator 2011;

Ministria e Drejtësisë - Ligji për Deklarimin e Pasurisë është miratuar dhe është në zbatim.

Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit – Projektligji për bibliotekat është përfshirë në Strategjinë Legjislative për vitin 2011. Ndërsa sa i përket bartjes së kompetencave në fushën e kulturës nga niveli qendror në nivel lokal është bërë transferimi i kompetencave të bibliotekave dhe teatrove, kompetencë kjo e cila është duke u ushtruar në nivelin lokal bazuar në memorandumet e Mirëkuptimit të nënshkruara.

Fokusi i aktiviteteve në periudhën e ardhshme 3 mujore të punës së Grupit Punues për Reformën e Legjislacionit dhe Bartjen e Kompetencave

- Raportimi nga Ministritë e linjës për zbatimin e Strategjisë Legjislative 2011 dhe sigurimi i harmonizimit të bazës ligjore me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale
- Miratimi i listës së ligjeve që kërkojnë harmonizim me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale
- Vazhdimi i punës për bartjen e kompetencave nga komunat amë në komunat e reja
- Përcaktimi i kompetencave komunale në përputhje me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale si menaxhimi i ujit, grumbullimi i mbeturinave etj., sidomos në komunat e reja.

Grupi Punues për Koordinimin e Donatorëve dhe Ngritjen e Kapaciteteve (GPKDNK)

Aktivitetet e këtij grupi kryesisht janë përqendruar në forcimin dhe zhvillimin e kapaciteteve të komunave. Qëllimi kryesor i këtij grupi është rritja e efektivitetit të përkrahjes si dhe evitimi i strukturave të dublifikuara koordinuese dhe do të shërbejë si strukturë e përbashkët nacionale për koordinimin e ndihmës së jashtme dhe ngritjes së kapaciteteve institucionale.

Për të pasur një qasje të integruar të ngritjes (zhvillimit) të kapaciteteve në të gjitha komunitat e Republikës së Kosovës, përfshirë edhe Komunitat e reja, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka hartuar Planin Strategjik për Zhvillimin e Kapaciteteve në Komunitat 2010-2015, si dhe Planin e Veprimit për këtë Plan Strategjik.

Po ashtu, MAPL ka hartuar një Plan të veçantë për ngritjen e kapaciteteve të komunave të reja. Aktivitetet për zbatimin e këtij Plani kanë nisur nga fillimi i muajit nëntor 2010. Këto aktivitete mbështet SDK/UNDP, ndërkohë i gjithë koordinimi i aktiviteteve është bërë nga MAPL dhe KIPA. Në këto trajnime, varësisht nga fusha, në 10 module trajnimi ku kanë marrë pjesë gjithsej 150 shërbyes civilë dhe përfaqësues të kuvendeve të Komunave. Gjatë këtyre sesioneve të trajnimit janë diskutuar temat si vijon: Legjislacioni për qeverisjen; Roli i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe reforma në qeverisjen lokale; Draftimi i akteve normative; Planifikimi i buxhetit; Të hyrat vetanake të Komunave; Menaxhimi i projekteve; Menaxhimi i resurseve njerëzore; Regjistrimi civil dhe barazia gjinore në Komunitat.

Me rastin e hyrjes në fuqi të Ligjit të ri të shërbimit civil, në bashkëpunim me USAID/DEMI, janë organizuar dy module trajnimi me të gjithë shefat e personelit dhe drejtorë administratës së komunave. Me këtë rast, janë certifikuar gjithsej 80 zyrtarë komunal.

Me rastin e hyrjes në fuqi të ligjit të ri të menaxhimit të pronës publike komunale dhe Ligjit për partneritetin Publiko-privat, janë organizuar trajnimet me zyrtarë komunal. Ndërsa me qëllim të informimit sa më të mirë, të zyrtareve komunal të komunave të reja, duke përfshirë këtu edhe përfaqësuesit e Kuvendeve të Komunave dhe Komitetëve, në bashkëpunim me USAID/DEMI, janë organizuar trajnime, me temat si vijon: transparenca Komunal; mbikëqyrja e akteve komunale dhe menaxhimi i pronës komunale.

Në bashkëpunim me OSBE-në, është hartuar dhe është realizuar projekti për ngritjen e kapaciteteve të zyrtarëve komunal, në lidhje me cilësinë e akteve komunale. Me këtë rast, janë organizuar seminare dyditore me të gjithë drejtorët e Administratës së komunave dhe kryesuesit e kuvendeve të Komunave.

Në bashkëpunim me SDK/UNDP dhe KIPA, në kuadër të zhvillimit të kapaciteteve të zyrtarëve të drejtave të njeriut, janë organizuar gjithsej 5 module trajnimi.

Me qëllim të ngritjes së kapaciteteve të zyrtarëve komunalë në fushën e teknologjisë informative, duke përfshirë këtu edhe përdorimin e softuerit, MAPL ka realizuar projektin "Shërbime të trajnimit për zyrtarët komunalë në përdorimin e TI" - Program evropian për certifikim ECDL (European Computer Driving Licence). Në fazën e parë janë certifikuar 398 zyrtarë komunalë, ndërsa në fazën e dytë 67 të tjerë, të cilët kanë përfunduar me sukses programet e këtij trajnimi.

Në bashkëpunim të ngushtë me ZNC-në, aktivitetet kryesisht janë zhvilluar në çështjet që kanë të bëjnë me rekrutimin e EPK-ve në Mitrovicë, si dhe publikimin e listës së OJQ-ve që kanë fituar të drejtën e marrjes së fondeve nga Qeveria e Kosovës, për implementimin e aktiviteteve që do të rezultojnë në ngritjen dhe stimulimin e marrëdhënieve ndërmjet komuniteteve të ndryshme në këtë pjesë të Kosovës. Këto aktivitete vlerësohet të kenë ndikim në multietnicitet, kontribuim dhe bashkëpunim të përbashkët ndërmjet komuniteteve të ndryshme.

Komunat e themeluara kanë shfaqur rezultate të arritura në çështjen e ngritjes së kapaciteteve dhe zhvillimit të këtyre kapaciteteve në përgjithësi, si në aspektin politik, po ashtu dhe atë administrativ.

Për sa i përket strategjive në Komunat e reja, UNDP-ja ka mbështetur hartimin e Strategjive për zhvillim të komunave të reja. Komuna e Graçanicës/Gračanica, Klllokotit/Klokot dhe Ranillugut/Ranilug janë miratuar strategjitë e propozuara në mënyrë që ato të shërbejnë si udhërrëfyes për Menaxhmentet Komunale. Në komunën e Parteshit/Parteš MAPL dhe UNDP aktualisht janë duke e përkrahur këtë komunë në funksionalizimin e ZKK-së dhe në përpilimin e strategjisë komunale zhvillimore.

Një bashkëpunim i ngushtë është realizuar dhe me Komisionin Evropian dhe deri më tani janë nënshkruar gjithsej 29 Projekte për infrastrukturën e komunave të reja/objektet e tyre administrative.

Të gjitha aktivitetet e parapara në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal janë realizuar sipas planit të paraparë të punës. Realizimi i aktiviteteve të parapara në pajtueshmëri me planin e punës është bërë dhe nga ana e USAID, ZNKE, dhe UNDP.

Mbështetje MAPL -së i është ofruar nga Projektet vijuese:

- EULOG - me komponentë që përfshijnë: menaxhimin e komunave, plani zhvillimor komunal, inspektimin dhe bashkëpunimin komunal si dhe realizimin e trajnimeve të ndryshme në komuna.

- Projekti i USAID-it "Iniciativa për Zhvillim dhe Stabilitet Fiskal në Kosovë" ka këto objektiva duke përfshirë: Partneritetin Publiko Privat, Menaxhimin e Financave Publike dhe Politikën Ekonomike. Projekti përfshinë fokusin në Qeverisjen Lokale dhe ka për qëllim sigurimin e Përmirësimit të Performancës së Menaxhimit të Financave Publike, Autonomi dhe Efikasitet të Institucioneve Vetë Qeverisëse, Zhvillimin Ekonomik Lokal, dhe Shërbime publike të standardeve të larta. Projekti do t'u ofrojë mbështetje Komunave në: PPP Komunal (përfshirë institucionalizimin e PPP-ve si dhe Zhvillimin dhe Implementimin e Programeve të PPP-ve). Rezultatet e parapara të Projektit përfshijnë: Sistemet e MFP, Proceset, Institucionet, Resurset Komunale, Zhvillimi lokal Ekonomik, si dhe certifikimi i zyrtarëve të MFP-së dhe certifikimi për funksionet e transferuar të thesarit, në Komunitat e reja.

- Projekti i USAID-it 'Iniciativa për Komuna Demokratike dhe Efektive'. Komponentët kyç të këtij projekti janë; përforsimi i administrimit komunal, fuqizimi i kuvendëve komunale, mbështetje në angazhimin e qytetarëve, përmirësimi i ofrimit të shërbimeve si dhe promovimi i zhvillimit lokal ekonomik.

- Është bërë hartimi dhe finalizimi i formatit të përmbajtjes së bazës elektronike të të dhënave në mbështetje të Projektit të Bankës Botërore bazuar në strategjinë E -qeverisje, E-administratë, shërbime mobile, me qëllim të avancimit të proceseve të punës në MAPL dhe në Komuna me qëllim të sigurimit të ofrimit të shërbimeve sa më efikase për qytetarë, biznese dhe qeveri. Baza elektronike e të dhënave në kuptimin infrastrukturorë dhe funksionalë është finalizuar dhe pritet që të plotësohet dhe më tutje me të dhëna që konsiderohen të jenë aktuale. Ky sistem është pjesë e qeverisjes elektronike 2009-2015 dhe posedon mekanizma të komunikimit në nivel të shërbimeve.

- MAPL po ashtu ka përfutur dhe nga projekti i financuar nga Bashkimi Evropian dhe menaxhuar nga Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian - 'Bashkëpunim Ndërkufitar'. Qëllimi kryesor i projektit është promovimi dhe zbatimi i Bashkëpunimit Ndërkufitar si dhe integrimi socio-ekonomik ndërmjet regjioneve në kufi me Kosovën, përmes fuqizimit të sektorit ekonomik, social, mjedisor dhe kulturor.

Komponentët kryesor të projektit janë: programimi i Bashkëpunimit Ndërkufitarë, ngritja e kapaciteteve për Bashkëpunim Ndërkufitar si dhe zbatimi i Bashkëpunimit Ndërkufitarë. Në përgjithësi aktivitetet e planifikuara për të ardhmen përfshijnë mbështetje e vazhdueshme ndaj MAPL-së, krijimi i kapaciteteve të BN-së si dhe trajnimi i stafit të MAPL-së.

- Projekti i Binjakëzimit - projekt i financuar nga Bashkimi Evropian dhe menaxhuar nga Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian, me objektiv të zhvillimit të administratës së Kosovës si dhe do mbështesë në përmbushjen e kërkesave të qeverisjes së një shoqërie funksionale në një mënyrë të përgjegjshme. Projekti ka për qëllim që të sigurojë se: të gjitha komunitatet e Kosovës ushtrojnë kompetencat e tyre në përputhje të plotë me planeve

komunale, të integruara plotësisht me buxhetin e komunës; përmirësimin e shërbimeve komunale duke siguruar që qytetarëve të Kosovës u ofrohen shërbime rregullative komunale.

- Projekti i UNDP-së në Mbështetje Procesit të Decentralizimit ofron përkrahje të Grupeve Punuese ndër-ministrore për Decentralizim, ofron mbështetje në themelimin e rregulloreve për bashkëpunim ndër-komunal dhe zbatimin e tyre, po ashtu planet zhvillimore për komunat e reja, hulumtimin mbi ofrimin e shërbimeve në nivel sa më të mirë për qytetarët, vlerësimi i nevojave për kapacitete si dhe zhvillimi i tyre, mbështetje në fushatat e përkrahjes së decentralizimit dhe themelimit të komunave të reja, si dhe mbështetje në sistemet kadastrale për komunat e reja. Në fokus çështjet që planifikohen të adresohen gjatë periudhës 2011-2013 përfshijnë: Adresimin e çështjeve të personelit si dhe cilësinë e menaxhimit në nivel komunal, menaxhimin efektiv komunal përmes transparencës dhe përgjegjësisë, fuqizimin e kohezionit shoqëror si dhe pjesëmarrjen publike në nivel lokal, mbështetje procesit të themelimit të komunave të reja, Mbështetjen e mekanizmave për ofrimin e shërbimeve efikase, partneriteti publiko-privat në mbështetje të zhvillimit ekonomik lokal, forcimin e sistemeve financiare komunale – bazuar në Ligjin për Financat e Qeverisjes Lokale, planifikimi komunal, mekanizmat dhe sistemet për ngritjen e Kapaciteteve Lokale, Përforcimi i shoqërisë së Qeverisjes lokale si dhe forcimi i sistemeve për komunikim ndër-qeveritarë si dhe adresimi i kontesteve ndër-qeveritare.

Po ashtu është bërë dhe prezantimi i planeve dhe projekteve nga komuniteti i donatorëve për veriun e Kosovës si dhe disa nga aktivitetet e planifikuara për vitin 2011.

MAPL në bashkëpunim të ngushtë me mekanizmat ndërkombëtarë është duke vazhduar me aktivitetet që kanë të bëjnë me: sensibilizimin e komunitetit për të marrë pjesë në zgjedhje dhe për të fituar legjitimitet demokratik si dhe për të bërë prezantimin në mënyrë legjitime në lidhje me shqetësimet dhe nevojat e qytetarëve të Veriut të Kosovës.

Disa nga projektet janë të dizajnuara dhe bëjnë implementimin e objektivave të tyre që kanë të bëjnë me përmirësimin e kualitetit të jetës së qytetarëve si dhe krijimin e një ambienti me besim të qytetarëve ndaj Institucioneve të Kosovës si dhe komunitetit ndërkombëtarë.

Çështjet më me prioritet janë: zhvillimi socio-ekonomik, puna që është duke u realizuar me komunitetin si dhe krijimi i kushteve për themelimin e komunës së re të Mitrovicës. Me qëllim të realizimit të këtyre objektivave, Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian ka ofruar mbështetje nëpërmjet realizimit të projekteve të ndryshme në pjesën veriore, duke përfshirë:

- Në Zubin Potok/Zubin Potok implementimi i veprimeve konkrete posaçërisht në qendrën shëndetësore e cila është e financuar për objektet e infrastrukturës komunale në bashkëpunim me MAPL-në

- Nënshkrimi i kontratës për realizimin e projektit me objektiv trajtimin e ujërave në pjesën Jugore të Mitrovicës por që mundëson qasje në ujë edhe për pjesën Veriore
- Projekti për zhvillim ekonomik rajonal i cili përfshin pesë regjione, dhe shërben si një platformë për dialog dhe bashkëpunim ndër komunal, ndonëse kryetari i komunës së Zubin Potok, Mitrovicë, Skenderaj dhe Vushtrri, janë angazhuar në mënyrë aktive për pjesëmarrje në këtë forum.
- Projekti i realizuar në objektin sportiv në Mitrovicë ka objektiv përmirësimin e kushteve të jetesës së banorëve posaçërisht përdorimi nga ana e të rinjve
- Projekti i realizuar nga BE dhe USAID për komunitetin RAE në Mitrovicë ka kontribuar që këtij komuniteti ti ofrohen kushte më të mira për jetesë, dhe se në fund të muajit Qershor 2011 do të bëhet edhe mbyllja e kampit Osterode.
- Mbështetja e kapaciteteve lokale komunale nga ana e Projektit të binjakëzimit, do të ndihmojë që do të ofrohet një cilësi shumë më e mirë për shërbimet ndaj qytetarëve në përgjithësi.
- Projekti në fushën e edukimit që ka për qëllim krijimin e bashkëpunimit ndërmjet universiteteve të ndryshme, duke ndihmuar në hapjen e zyrës së Tempusit në Mitrovicë si dhe themelimi e një qendre në Mitrovicë që tanimë veç është e themeluar në Prishtinë
- Projekti për mbështetjen e festivalit për fëmijë si dhe projekte tjera me fokus në mbështetje të kulturës.

USAID gjithashtu ka dhënë mbështetjen në krijimin e fondit të mirëbesimit dhe ka ndihmuar me disa projekte për Veriun, projekte këto të cilat janë në fazën e prokurimit (në fazën e përcaktimit të kriterëve). Fondi i mirëbesimit kryesisht do të fokusohet në infrastrukturë (infrastrukturë rrugore, shkolla, shtëpi të shëndetit, qendra të komunitetit etj), si dhe të holla për punë. Përveç këtyre USAID mbështet projektin që ka të bëjë me programin për ndryshime pozitive (kryesisht është i ndërlidhur me forumet e komunitetit) si dhe mbështetje të drejtpërdrejtë MAPL-së nëpërmjet projektit të DEMI-t.

UNDP ka përkrahur realizimin e aktiviteteve të tanishme si dhe planifikimin e aktiviteteve për të ardhmen në sektorë të ndryshëm si në: Zhvillimin ekonomik lokal, mbështetje në shërbimet komunale si dhe ngritjen e kapaciteteve në sektorin e shoqërisë civile në Mitrovicë.

Sa i përket zhvillimit ekonomik lokal janë themeluar tri qendra lokale këshilluese të bizneseve në pjesën Jugore dhe Veriore të Mitrovicës. UNDP në mënyrë të drejtpërdrejtë është e përfshirë në implementimin e projektit për partneritet të grave dhe rinisë dhe në bashkëpunim të ngushtë me MAPL-në ka bërë organizimin e aktiviteteve të ndryshme, siç është: organizimi i ngjarjes me OJQ-të nga Veriu dhe Jugu i qytetit të Mitrovicës si dhe ngjarje tjera të rëndësishme.

Në të ardhmen UNDP në bashkëpunim me MAPL-në do të bëjë përgatitjen e një raporti të posaçëm duke theksuar zhvillimin lokal, situatën politike, zgjedhjet dhe decentralizimin në Mitrovicë.

Aktivitetet e OSCE-së në të ardhmen do të përqendrohen në angazhimin e ekipit të ekspertëve në pjesën Veriore, veçanërisht në fushën e shoqërisë civile dhe rinisë, si dhe në promovimin e parimeve të përgjithshme të qeverisjes së mirë, qasjes në dokumente si dhe punën me komunitete.

Fokusi i aktiviteteve në periudhën e ardhshme 3 mujore të punës së Grupit Punues për Koordinimin e Donatorëve dhe Ngritjen e Kapaciteteve

Puna e Grupit punues për Koordinimin e Donatorëve dhe Ngritjen e Kapaciteteve do të përqendrohet në:

- Koordinimi dhe bashkërendimi i ndihmës me komunitetin e donatorëve për të financuar prioritetet e komunave të reja në infrastrukturën publike
- Koordinimi dhe bashkërendimi i ndihmës së jashtme për të financuar realizimin e Planit të veprimit për ngritjen e kapaciteteve institucionale të komunave përmes ndihmës teknike dhe organizimit të trajnimeve për stafet komunale
- Koordinimi dhe bashkërendimi i ndihmës për të ndihmuar bartjen e kompetencave dhe ngritjen e kapaciteteve komunale për absorbimin e këtyre kompetencave

Grupi Punues për Kontaktim me Publikun (GPKP)

Gjatë periudhës shtator 2010 – shkurt 2011 janë mbajtur dy takime të Grupit Punues.

Grupi punues për kontaktim me publikun ka pasur si objektiv kryesor gjatë kësaj periudhe kontaktin me publikun rreth procesit të decentralizimit në mënyrë që të informohen komunitetet e Kosovës për përparësitë e procesit të ri të reformës së vetëqeverisjes lokale në jetën e tyre të përditshme.

Gjatë periudhës së raportimit janë identifikuar grupet brenda shoqërisë për kryerjen e aktiviteteve të kontaktimit të publikut për decentralizimin, si dhe ka vazhduar puna për informimin e qytetarëve për procesin e decentralizimit. Një vëmendje e veçantë i është kushtuar gjatë gjithë kësaj kohe procesit të informimit të publikut në lidhje me krijimin dhe funksionalizimin e strukturave të komunave të reja.

Në shtator 2010 Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal në bashkëpunim me UNDP-në organizoi konferencën me temën “Roli i shoqërisë civile për zhvillimin e Mitrovicës” ku morën pjesë afro 60 përfaqësues nga Shoqëria civile dhe media. Konferenca pati për qëllim që përmes bashkëpunimit të Shoqërisë Civile, Organizatave Jo-Qeveritare nga Mitrovica nga jugu dhe e veriut të forcohen bashkëpunimi në proceset e shoqërisë multi-kulturore dhe multi-etnike.

Në tetor 2010 është prezantuar Strategjia e komunikimit me publikun, si dhe Plani i veprimit i kësaj Strategjie.

Janë realizuar tri debate për decentralizimin në Qendrën Mediale në Çagllavicë me temën e decentralizimit.

Më dhjetor 2010 është prezantuar raporti nga hulumtimi i opinionit publik për decentralizimin në Veri të Mitrovicës (Shtator 2010, MAPL- UNDP).

Në kuadër të fushatës informuese për decentralizimin janë planifikuar dhe realizuar gjatë periudhës shtator 2010 – shkurt 2011 njëzet e pesë emisione dhe debate televizive lidhur me proceset të cilat udhëhiqen nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal në televizionet publike dhe lokale të vendit.

Po ashtu, me qëllim realizimin e fushatës informuese për decentralizimin në Veri janë përgatitur katër dokumentarë që paraqesin procesin e decentralizimit si tregim i suksesshëm për Kosovën në drejtim të themelimit të komunave të reja, bartjes së kompetencave në komuna, investimeve në komuna dhe nevojën e implementimit të procesit të decentralizimit në Veri.

Këto dokumentarë janë transmetuar në dhjetor 2010 dhe janar 2011 në televizionet RTK, RTV, KTV, Klan Kosova, Rrokum TV, TV Mitrovica dhe TV Mir. Minutazhi i dokumentarëve ka përfshirë kohën prej 5 deri në 07 minuta.

Komunikimi me mediat rreth procesit të decentralizimit ka përfshirë këto aktivitete: konferenca për media, takime formale dhe joformale me gazetarë, komunikata, njoftime, intervista, përgjigje në pyetjet e drejtuara nga gazetarët dhe aktivitete të tjera.

Duke marrë parasysh kërkesat e mediave dhe interesimet e gazetarëve për të marrë informata lidhur me aktivitete të MAPL-së, vëmendje e veçantë në informimin e gazetarëve i është kushtuar informatave rreth procesit të decentralizimit, themelimit të komunave të reja, bartjes së kompetencave në komuna dhe informata për hapjen e qendrës për shërbimin civil në Veri.

Një mjet i rëndësishëm i komunikimit për informimin e qytetarëve ka qenë postimi i informatave dhe dokumenteve të rëndësishme të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal në faqet e internetit mapl-ks.org dhe decentralizimi.info.

Bashkëpunimi i mirë me mjetet e informimit publik është shprehur dhe në organizimin e konferencës “Përvojat e vetëqeverisjes lokale në Kosovë dhe perspektiva e saj” me rastin e pesë-vjetorit të themelimit të MAPL. Në këtë takim, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka ndarë mirënjohje për mediat elektronike dhe të shkruara.

Për më tepër, ZCN dhe Ekipi Përgatitor Komunal në Mitrovicën e Veriut kanë ndërmarrë aktivitete të ndryshme për të zbatuar strategjinë për kontakt me publikun.

Aktiviteti	Data	Zbatues	Audienca kyçe
Faqja e internetit e EPK/ faqja e Facebook	Nëntor 2010 - në vazhdim	EPK MV	Qytetarët e Mitrovicës së Veriut, Donatorët
Konkursi fotografik “Kultura në rrugën time”	Dhjetor 2010	EPK MV	Qytetarët e Mitrovicës së Veriut
“Një vision për Mitrovicën” Punëtori	Dhjetor 2010	ICOM	Udhëheqësit e komunitetit
Sondazhe të opinionit	Dhjetor 2010	ICOM	Qytetarët e Mitrovicës së Veriut
Shpërndarja e broshurave të decentralizimit	Dhjetor 2010, në vazhdim	EPK MV	Qytetarët e Mitrovicës së Veriut
Pritja e EPK-së	Shkurt 2011	EPK MV	Partnerët ndërkombëtarë, OJQ-të lokale, Qytetarë, GoK
Ekspozitë publike për konkursin fotografik	Shkurt 2011	EPK MV	Qytetarët e Mitrovicës së Veriut
Fokus grupi 1	Mars 2011	EPK MV	Qytetarët e

Fokus Grupi 2	Mars 2011	EPK MV	Mitrovicës së Veriut Qytetarët e
Fokus Grupi 3	Mars 2011	EPK MV	Mitrovicës së Veriut Qytetarët e
Fokus Grupi 4	Mars 2011	EPK MV	Mitrovicës së Veriut Qytetarët e

Fokusi i Aktiviteteve në periudhën e ardhshme 3 mujore të punës së Grupit për Kontaktim me Publikun

- Fushata informuese për qytetin e Mitrovicës me qëllim informimin sa më të drejtë të qytetarëve.
- Vazhdimi i bashkëpunimit me mjetet e informimit publik dhe krijimi i një partneriteti me to me qëllim final informimin e drejtë të qytetarëve.
- Mbështetja e Ekipit Përgatitor Komunal në lidhje me aktivitetet informuese që do të zhvillohen prej tyre.

Rekomandime:

- Zbatimi i agjendës legislative 2011 të aprovuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, duke siguruar harmonizimin e projekt-ligjeve të propozuara me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale.
- Zhvillimi i kapaciteteve institucionale të Komunave të reja përveç tjerash edhe përmes koordinimit të aktiviteteve që ofrohen nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Ministrinë e linjës, si edhe partnerët ndërkombëtarë.
- Miratohen Termat e Referencës për punën dhe organizimin e EPK-së të Mitrovicës së Veriut dhe obligohet MAPL dhe ZCN që duke u koordinuar me ministrinë e linjës dhe partnerët të përgatisë dhe adaptojë planin vjetor të veprimit të EPK-së
- Fuqizimi i koordinimit ndërministror për të funksionalizuar plotësisht punën e grupeve punuese për decentralizim.
- Përpilimi i planit të veprimit për vitin 2011 për të siguruar kushtet e nevojshme për organizimin me sukses të zgjedhjeve lokale për Mitrovicën e Veriut.
- Përgatitja e një plani veprimi për aktivitetet në Mitrovicën e Veriut për vitin 2011.
- Përgatitja e buxhetit të komunës Mitrovicë e Veriut për vitin 2012.
- Përpilimi i parimeve dhe kriterëve për të filluar procesin e konsultimeve me komunitetet lokale që mund të kualifikohen për ngritjen e komunave të reja dhe dërgimin për aprovim nga Qeveria e Republikës së Kosovës.